VENDIM
Nr.278, datë 6.4.2011

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.1532, DATË 19.11.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË BASHKISË KORÇË TË QARKUT TË KORÇËS"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës "b" të nenit 8/a të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike, të shtetit, në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në listën e inventarit që i bashkëlidhet vendimit të Këshillit të Ministrave, nr.1532, datë 19.11.2008 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të bashkisë së Korçës të qarkut të Korçës" hiqen pronat me nr.956, 861, 864, sipas formularëve që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Bashkisë Korçë i revokohet e drejta e pronësisë për pronat me nr.956, 861, 864, të cilat përfshihen në fushën e veprimit të ligjit për kthimin dhe kompensimin e pronave.

3. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, Ministri i Ekonomisë Tregtisë dhe Energjetikës dhe Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha